



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.13/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarës V.H.R, gjyqtarit S.H dhe gjyqtarit SH.C, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga B. I. – Z. L. në K.c., rruga “A. Zh.”, M. e S., k., nr., P., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 24.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga B. I. – Z. L. në K.c, ndaj gjyqtarës V.H.R, gjyqtarit S.SH, gjyqtarit SH.C, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 25.10.2022, përmes e-mailit B. I. – Z. L. në K.c., rruga “., rruga “A. Zh.”, M. e S., k.1, nr.7, P., ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj trupit gjykues të përbërë nga gjyqtarja V.H.R, gjyqtari S.H dhe gjyqtari SH.C, me pretendimin se gjyqtarët me veprimet e tyre kanë rënë ndesh me nenin 5 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me arsyetimin se me datë 14 tetor 2022, me rastin e shpalljes së aktgjykimit në çështjen penale ndaj të pandehurit SH. G., i akuzuar për vepër penale vrasje e rëndë dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, e cila shpallje u bë në sallë të gjykimit dhe në prezencën e shumë forcave policore, mediave të pranishme dhe publikut, ku në sallë ishin të pranishëm edhe fëmijët e të ndjerit A. T., të moshës tetë (8) vjeçare. Parashtruesja e ankesës, ka theksuar se Kryetarja e Trupit Gjykues nuk i ka larguar nga salla fëmijët e të ndjerit madje, nuk ka pas as verifikim të moshës së tyre nga ana e saj, si person kompetent për të vlerësuar prezencën e personave në sallën e gjykimit duke shtuar se prezenca e fëmijëve të moshës tetë (8) vjeçare në shpallje të dënimit për vrasje të rëndë, në çfarëdo versioni paraqet ndikim negativ te ata pasi në shpallje lexohet dispozitivi i aktgjykimit dhe ditën kritike, fëmijët prezent kanë dëgjuar se si babai i tyre është vrarë në vendin e punës me armë. Përveç kësaj, parashtruesja e ankesës ka shtuar se po ashtu, fotografitë e tyre janë shpërndarë në të gjitha mediat dhe rrjetet sociale pasi nga gjyqtarja, nuk ka pas asnjë kufizim apo paralajmërim ndaj mediave prezentë për të mbrojtur identitetin e fëmijëve. Andaj, vlerëson se veprimet e trupit gjykues janë të përfshira në shkelje disiplinore, pasi kanë rënë ndesh me nenin 293 par.2 të Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit, në shqyrtim gjyqësor mund të marrin pjesë vetëm personat madhor, që do të thotë se në shqyrtim gjyqësor nuk lejohet prezenca e fëmijëve në cilësi të publikut për faktin se ekziston mundësia e ndikimit negativ tek ata. Parashtruesja e ankesës po ashtu ka theksuar se Gjykata Themelore në Pejë, në një përgjigje për K.c. ka thënë se, Trupi Gjykues i kryesuar nga gjyqtarja V.H.R, nuk kanë qenë në dijeni për prezencën e fëmijëve të mitur të viktimës në sallën e gjykimit, ditën kur është bërë shpallja e aktgjykimit dhe sipas arsyetimit të trupit gjykues në prezencën e një numri të madh të personave në sallë, të kamerave të shumta dhe numrit të madh të zyrtarëve policor në sallë, trupi gjykues e

ka pas të pamundur të vërej prezencën e dy fëmijëve në mesin e publikut. Megjithatë, e njëjta vlerëson se kjo deklaratë e trupit gjykues është në tërësi kundërthënëse me video incizimet që i posedojnë pasi fëmijët kanë qenë në rendin e parë të ulëseve në gjykatë pra, trupi gjykues ka qenë përball tyre dhe distanca e tyre ka qenë shumë e afërt për shkak të sallës së vogël por, edhe sikur të ndodhte e kundërta është i papranueshëm arsyetimi se 3 gjyqtarë nuk i kanë vërejtur fëmijët pasi, trupit gjykues është i obliguar që në shpallje të verifikoj prezencën e personave në mënyre që mos të këtë shkelje të ligjit. Parashtruesja e ankesës, si provë ka përcjellë shkrimin e publikuar nga K.c. me titull “Fëmijët e A. T. prezent në Gjykatë, presin shpalljen e vendimit për vrasjen e babait të tyre” si dhe një videoincizim i shpalljes së aktgjykimit nga trupi gjykues, i publikuar nga K.c.

Me datë 26.10.2022, në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është njoftuar për ankesën disiplinore të parashtruar ndaj gjyqtarës V.H.R, gjyqtarit S.H dhe gjyqtarit SH.C.

Gjyqtarja V.H.R, në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me ankesën disiplinore të parashtruar nga K.c., ndaj saj si Kryetare e Trupit Gjykues dhe anëtarëve të trupit gjykues S.H dhe SH.C, në lëndën penale ndaj të pandehurve Sh. G. dhe I. C., me pretendimin se me rastin e shpalljes së aktgjykimit, me datë 14.10.2022, në sallën e gjykimit kanë marrë pjesë edhe fëmijët e të ndjerit A. T., ka deklaruar se si kryetare e trupit gjykues nuk ka qenë e njoftuar se fëmijët janë prezent në sallë, as nga sigurimi i gjykatës e as nga policia dhe se këtë fakt e ka kuptuar në portale pas seancës. E njëjta, ka theksuar se nga policia është njoftuar se ka shumë publik, monitorues dhe media dhe se salla është e vogël pastaj, sërish në zyrën e saj ka shkuar një zyrtar policor i cili e njoftuar se avokati B.B. është ulur në bankën e avokatit, për çka gojarisht ju ka thënë se avokati duhet të largohet nga banka e avokatit. Ndërsa, sa i përket publikut - personave të interesuar, e njëjta ka shtuar se ju ka thënë që t’i lejojnë në një numër të kufizuar pasi, ka shumë monitorues dhe media të cilëve nuk mund t’ua mohojmë pjesëmarrjen. E njëjta ka shtuar se pas publikimit në media që në sallë kanë qenë fëmijët e viktimës në rastin Sh. G., ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës që të verifikohet se pse është lejuar nga sigurimi hyrja e fëmijëve në gjykatë e po ashtu, të kërkohet edhe nga përgjegjësi i policisë se pse kanë lejuar hyrjen e fëmijëve apo eventualisht, ka kërkuar t’ua dijë pse nuk është njoftuar apo të paktën pse nuk është pyetur a lejohet pjesëmarrja e fëmijëve në sallë, pasi që kjo nuk ka ndodh kurrë më parë. Gjyqtarja H.R, në deklaratën e saj po ashtu ka potencuar se dihet se gjyqtari nuk është përgjegjës për verifikim të publikut në sallë pasi këtë detyrë e kryen sigurimi i gjykatës, e para hyrjes në sallë të njëjtit serish i verifikon policia, duke ritheksuar se fëmijët nuk i ka parë në sallë dhe as nuk e din se ku kanë qenë të ulur dhe nëse shikohen video incizimet e publikuara, vërehet se kur trupi gjykues hynë në sallë të gjithë janë të ngritur në këmbë e po ashtu, janë një numër i policëve të cilët janë edhe para familjarëve të dëmtuarve pastaj, e njëjta deklaroi se është fokusuar në lexim të aktgjykimit të cilin e kanë shpallur. Përfundimisht, gjyqtarja ka theksuar se gjatë gjithë detyrës së saj si gjyqtare është përpjekur që çdo gjë të jetë transparente deri në atë masë sa është e lejuar me ligj, duke mos i shkelur të drejtat e palëve në procedurë ndërkaq, sa i përket publikimit në media të fëmijëve, ka deklaruar se nuk ka pas mundësi t’ua ndaloj pasi që nuk e ka ditë që fëmijët janë në sallë.

Gjyqtari S.H dhe gjyqtari SH.C, në deklaratat e tyre të dhëna me shkrim lidhur me ankesën disiplinore të parashtruar nga K.c. ndaj tyre si anëtar të trupit gjykues në lëndën penale ndaj të pandehurve Sh. G. dhe I. C., të parashtruar me arsyetimin se me datë 14.10.2022, me rastin e shpalljes së aktgjykimit, në sallën e gjykimit kanë marrë pjesë edhe fëmijët e të ndjerit A. T., të njëjtit kanë deklaruar se ditën e shpalljes së gjykimit trupin gjykues nuk e ka njoftuar askush se në

publik ka fëmijë ngase, po qe se do t'a kishin ditë një rrethanë të tillë, sigurisht se do të kishin vepruar por, as nga ana e sigurimit e as nga ana e policisë nuk ka pasur njoftim se në sallë gjenden fëmijët. Po ashtu, kanë shtuar se askush nuk ka kërkuar leje nga trupi gjykues që fëmijët e të ndjerit të hynë në sallën e gjykimit ndërsa, kur trupi gjykues ka shkuar në sallë, aty ka pasur shumë pjesëmarrës si dhe shumë media dhe se të njëjtit kanë pohuar se në asnjë moment nuk ju kanë rënë në sy se fëmijët gjenden aty ngase asnjëherë, nuk kanë qenë të përqendruar më shikim nga pjesë të caktuara të publikut.

Në drejtim të sqarimit të rrethanave të rastit, Kryetari i Gjykatës ka marrë deklaratat e zyrtarëve të sigurimit që kanë qenë në detyrë me datë 14.10.2022.

Në deklaratën e dhënë me shkrim me datë 21.10.2022, dy zyrtarët e sigurimit kanë theksuar se me datë 14.10.2022, palët që i kanë lënë për të hyrë në gjykatë janë vetëm ato palë të cilat policia ju ka thënë që t'i lejojnë për të hyrë brenda pra, policia ka caktuar se nga sa persona mund të hyjnë në sallë dhe se në raste të tilla është përgjegjësi e policisë që të vendosin për lejimin apo moslejimin e personave të caktuar në sallë.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar së bashku me prova dhe deklaratat e gjyqtarëve ka gjetur se ankesa disiplinore e parashtruar ndaj gjyqtarës V.H.R, gjyqtarit S.SH, gjyqtarit SH.C, është e pabazuar.

Lidhur me pretendimet e parashtrueses së ankesës disiplinore B. I., se trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarja V.H.R – kryetare dhe gjyqtarët S.H dhe SH.C – anëtar, kanë kryer shkelje disiplinore nga neni 5 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve pasi, kanë rënë ndesh me nenin 293 par.2 të KPPRK-së duke shpall aktgjykimin ndaj të pandehurit të akuzuar për vrasje të rëndë, gjatë kohë sa në sallën e gjykimit kanë qenë prezent fëmijët viktimës së ndjerë, të cilët janë të moshës tetë (8) vjeçare, e të cilët Kryetarja e Trupit Gjykues nuk i ka larguar nga salla madje, as nuk e ka bërë verifikimin e moshës së tyre si person kompetent për të vlerësuar prezencën e personave në sallën e gjykimit, Kryetari i Gjykatës, si autoritet kompetent ka gjetur se ankesa disiplinore e mbështetur në këto pretendime nuk gjen mbështetje për arsye se:

Neni 5 par.1 pika 1.2 e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka paraparë se *gjyqtari kryen shkelje disiplinore nëse ai ose ajo shkel ligjin*. Pretendimin se trupi gjykues e ka shkelë ligjin, parashtruesja e ankesës e ka mbështetë në faktin se të njëjtit kanë vepruar në kundërshtim me nenin 293 par.2 të KPPRK-së, sipas të cilit *në shqyrtim gjyqësor mund të marrin pjesë personat madhor*.

Fillimisht, është e rëndësishme të sqarohet se pretendimi se gjyqtarët kanë shkelë ligjin për shkak se kanë vepruar në kundërshtim me nenin 293 par.2 të KPPRK-së, është pretendim jo i saktë për faktin se neni 357 par.1 i KPPRK-së, sqaron se trupi gjykues e shpall të mbyllur shqyrtimi gjyqësor pas dhënies së fjalës përfundimtare të palëve. Faza në të cilën bëhet fjalë në këtë ankesë disiplinore është faza e shpalljes së aktgjykimit, në të cilin zbatohet dispozita e nenit 366 të KPPRK-së ku përcaktohet se *dispozitivi i aktgjykimit gjithmonë lexohet në seancë të hapur*.

Pra parimisht, shpallja e aktgjykimit është e hapur për publikun. Andaj, dispozita e nenit 293 të KPPRK-së me të cilën përcaktohet se në shqyrtim gjyqësor mund të marrin pjesë personat madhor, nuk mund të aplikohet në mënyrë analoge ashtu që pjesëmarrja e fëmijëve në shpallje të

aktgjykimit, të trajtohet si shkelje e ligjit konkretisht, si shkelje e nenit 366 të KPPRK-së, e me këtë trupit gjykues t'i vihet në barrë shkelja disiplinore nga nenit 5 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Përkundër mungesës së bazës ligjore mbi të cilën është mbështetë ankesa disiplinore, Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent, me vëmendje dhe përkushtim të veçantë ka analizuar të gjitha pretendimet dhe provat lidhur me rastin dhe ka gjetur se:

Nga deklarata e gjyqtarëve u vërtetua se fillimisht, trupi gjykues nuk është njoftuar nga zyrtarët policor - të cilët kanë për obligim që t'i legjitimojnë personat që hyjnë në sallë të gjykimit si dhe të sigurojnë sallën gjatë shpalljes së vendimit, se prezent në sallë ku do të shpallet gjykimi ka fëmijë. Informatë kjo që patjetër do të duhej t'i jepej trupit gjykues. Shto këtu faktin se, zyrtarët policor, duke qenë të ngarkuar me detyrën e sigurimit të sallës dhe legjitimit të personave që hyjnë në sallë, e duke qenë të vetëdijsëm se prezenca e fëmijëve në sallë lejohet ekskluzivisht vetëm në rastet e parapara me ligj, as që është dashur të lejojnë hyrjen e fëmijëve në sallën e gjykimit!

Në anën tjetër, pavarësisht faktit se parashtruesja e ankesës thekson se salla është e vogël dhe dy fëmijët kanë qenë në rendin e parë të ulëseve përballë trupit gjykues ashtu si nga deklaratat e gjyqtarëve edhe nga video incizimi, autoriteti kompetent nuk ka mundur t'a vërtetoj se kryetarja e trupit gjykues apo dy anëtarët e saj, nga momenti i hyrjes së tyre në sallë e deri sa janë larguar nga salla e gjykimit, t'i kenë vërejte dy fëmijët që kanë qenë prezent në sallën e gjykimit gjatë kohës së shpalljes.

Rrethana e lartcekur, lehtësisht vërtetohet nga video incizimi ku shihet se në momentin e hyrjes së trupit gjykues në sallë të gjithë të pranishmit ngritën në këmbë, në këtë drejtim duke pas parasysh faktin se salla e gjykimit është mjaftë e vogël dhe se në sallë vërehet prezenca e një numri të madh të publikut, policëve, gazetarëve dhe kamerave të disa televizioneve, lehtësisht mund të arrihet në përfundimin se trupi gjykues në prezencën e rrethanave të lartcekurave, nuk e kanë vërejte prezencën e dy fëmijëve në sallë sepse në të kundërtën, të tre gjyqtarët, duke qenë profesionist të fushës, e duke e ditur mirë seriozitetin punës së gjykatës dhe ndikimin që ka ajo në gjendjen psikike dhe emocionale të fëmijëve, assesi nuk do t'a lejonin ekspozimin e tyre para aktit solemn të shpalljes së dënimit ndaj një të pandehuri të akuzuar për vrasje, e aq më pak kur viktimë e rastit është babai i tyre.

Andaj, meqë autoritetit kompetent me asnjë provë dhe në asnjë mënyrë nuk u bind se trupi gjykues ka pas njohuri se në sallën ku e kanë bërë shpalljen e gjykimit ka fëmijë dhe përkundër këtij fakti e kanë lejuar prezencën e tyre në sallë vlerëson se, pakujdesia e zyrtarëve policor të cilët ditën në fjalë kanë qenë të ngarkuar me detyrën e sigurimit të sallës dhe legjitimit të personave që hyjnë në sallë të gjykimit, në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për t'a njoftuar trupin gjykues për prezencën e fëmijëve në sallë të gjykimit apo për t'i larguar fëmijët nga salla, nuk mund t'i atribuohet trupit gjykues si shkelje e natyrës disiplinore.

Lidhur me pretendimin se gjyqtarja V.H.R, ka kryer shkelje të natyrës disiplinore meqë fotografitë e fëmijëve janë shpërndarë në media dhe rrjete sociale, pasi e njëjta nuk i ka paralajmëruar mediat prezentë për të mbrojtur identitetin e fëmijëve, Kryetari i Gjykatës në cilësinë e autoritetit kompetent gjen se edhe ky pretendim është tërësisht i pabazuar meqë, Kryetarja e Trupit Gjykues fillimisht, nuk ka qenë e vetëdijshme e as e informuar për prezencën e dy fëmijëve në sallë gjatë

kohës së shpalljes së aktgjykimit e në rrethana të tilla, natyrshëm se e njëjta, nuk ka pas se si të ndërmarrë veprime në drejtim të mbrojtjes së tyre nga ekspozimi ndaj mediave prezentë në sallë. Në këtë pikë, mbrojtja e identitetit dhe respektimi i dinjitetit të fëmijëve nga publikimi në media, hyn në fushë veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Mediave e jo të trupit gjykues.

Përfundimisht, autoriteti kompetent, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm se pjesëmarrja e fëmijëve të moshës tetë (8) vjeçare përgjithësisht, pjesëmarrja e personave nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare në sallën e gjykimit (përveç rasteve të parapara shprehimisht me ligj) është tërësisht e papranueshme dhe rast i paprecedentë në Gjykatën Themelore në Pejë, e dënon rëndë mos informimin e trupit gjykues dhe mos ndërmarrjen e masave nga zyrtarët policor përgjegjës për largimin e fëmijëve nga salla e gjykimit megjithatë, rrethana e tillë nuk hyn në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore nga ana e gjyqtarëve andaj, ankesa disiplinore u refuzua si e pabazuar.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.13/22, me datë 24.11.2022.

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. Gjyqtarës V.H.R
3. Gjyqtarit S.SH
4. Gjyqtarit SH.C
5. Parashtrueses së ankesës – B. I.